

NË GJYKATEN THEMELORE TË PEJES
Numri i lëndës, P.nr.386/13
Data: 8 Prill 2014

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata themelore e Pejës, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Mariola Pashnik si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarit Manuel Soares dhe Lunturiqe Muhaxherri si anëtar të trupit gjykues dhe procesmbajtësja Jacqueline Ryan në lëndën penale kundër:

I. S. [REDACTED], [REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]
[REDACTED]

I akuzuar sipas modifikimit të aktakuzës të Zyrës së prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ("PSRK"), PPS. nr. 85/10 të datës 31 Janar 2014, me veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit në kundërshtim me nenin 422 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ("KPRK") dhe në ndihmës të ish gjyqtarit K. [REDACTED] P. [REDACTED] i lidhur me veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshëm të vendimeve të gjykatës në kundërshtim me nenin 432 i lidhur me nenin 33 të KPRK-se.

Pas mbajtjes së shqyrtimit publik me 26, 27 dhe 28 Shkurt dhe më 2, 3 dhe 8 Prill të vitit 2014, ku Ali Rexha u paraqit për prokurorinë, palët e dëmtuara F. [REDACTED] G. [REDACTED] dhe Fondi Garantues i Kosovës (tani byroja e sigurimit të Kosovës) janë ftuar, G. [REDACTED] K. [REDACTED] për I. S. [REDACTED] dhe ku i pandehurit ishte prezent gjatë tërë seancës, pas këshillim - votimit të mbajtur me 3 Prill 2014 ka shpallu në publik si në vijim:

AKTGJYKIM

I.

Në mbështetje të nenit 388 (1) dhe nenit 391 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK") i pandehuri I. S. [REDACTED] shpallet:

FAJTOR

Sepse:

Nga 22 janari 2008 deri me 8 Prill 2008 ne objekte te gjykatës komunale te K [REDACTED], duke vepruar ne pozite zyrtare te asaj kohe te përfaqësuesit te ish Fondit Garantues te Kosovës ne Prishtine dhe duke përdor detyrën e tij zyrtare apo autoritetin e ka rejkalluar autoritetin e tij duke mos përmbushur detyrat e tij zyrtare, me qëllim te përftimit te dobisë materiale për vete apo për K [REDACTED] P [REDACTED] dhe I [REDACTED] F [REDACTED], duke shkaktuar dem personit tjetër domethënë Fondit garantues te Kosovës ne Prishtine ne bashkëkryerje me K [REDACTED] P [REDACTED] dhe I [REDACTED] F [REDACTED].

Në fillim K [REDACTED] P [REDACTED] dhe I [REDACTED] F [REDACTED] me ane te marrëveshjes paraprake e kane falsifikuar flete lëshimin nr. 10344 te datës 22 shtator 2006 ne emër te palës se dëmtuar F [REDACTED] G [REDACTED] nen pretekst se ai ka vuajtur lëndime te renda trupore me fraktura te ekstremiteteve etj. Ne aksidentin trafik i cili ka ndodhur me 13 shtator 2006. Më pas ata e hartuan padinë ne procedure civile për kompensim ne emër te F [REDACTED] G [REDACTED] ne vlerën prej 50.000.000\$. ky rast është regjistruar ne gjykatën komunale te Klinës me numër te lendes C. nr. 271/2007. K [REDACTED] P [REDACTED] është caktuar si gjyqtar ne këtë rast. Ai e ka caktuar seancën me 22 Janar 2008. Ai e ka ftuar avokatin I [REDACTED] F [REDACTED] (i cili nuk ka pasur autorizim) dhe përfaqësuesi i palës se paditur, I [REDACTED] S [REDACTED]. Rasti ka vazhduar me 5 shqyrtime. I pandehuri I [REDACTED] S [REDACTED] nuk ka marre pjese ne seance me 25 Mars 2008. I pandehuri I [REDACTED] S [REDACTED] ne marrëveshje me K [REDACTED] P [REDACTED] me qëllim nuk e ka përfaqësuar kompaninë e tij ne mënyrë te duhur, te vlefshme dhe profesionale, duke mos kërkuar për seancën gjyqësore qe te mbahet ne mënyrë te rregullt; duke mos kërkuar autorizimin valid te lëshuar nga pala e dëmtuar, F [REDACTED] G [REDACTED], më pas duke mos kërkuar për palën e dëmtuar F [REDACTED] G [REDACTED] qe te jete prezent ne shqyrtimet kryesore, duke mos kërkuar sqarime nga eksperti ortopedisë B [REDACTED] B [REDACTED] (pasi qe raporti i tij si ekspert deklaroi se pala e dëmtuar F [REDACTED] G [REDACTED] ka pësuar lëndime te renda trupore qe kane shkaktuar 100% paaftësi etj.), duke lejuar nxjerrjen e vendime te kundërligjshme gjyqësore qe ishin ne dëm te palës se dëmtuar, fondit garantues te atëhershëm te Kosovës qe ai e përfaqësonte.

Rrjedhimisht, B [REDACTED] E [REDACTED], vetëm ne baze te formës se falsifikuar te flete lëshimit, e ka siguruar raportin e tij si ekspert duke cekur se F [REDACTED] G [REDACTED] ka pësuar lëndime te renda trupore qe kane rezultuar ne pasoja te pafavorshëm te shëndetit, duke përfshirë, frikën, shëmtim, zvogëlim permanent te aktiviteteteve vitale, reduktim te aktiviteteteve te punës, me nevojje te ndihmës nga personi i trete, ushqyerje te mbështetur dhe tretman mjekësor ne te ardhmen, edhe pse asnjëra nga këto nuk ishin te vërteta.

Së fundi K [REDACTED] P [REDACTED], duke vepruar si kryetar i trupit gjykues, i ka udhëzuar "palët gjyqësore" që të arrijnë një marrëveshje. Pas marrëveshjes ndërmjet I [REDACTED] S [REDACTED] dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, Fondi garantues i Kosovës në Prishtinë dhe avokatit I [REDACTED] E [REDACTED], përfaqësuesi i pa autorizuar i palës së dëmtuar F [REDACTED] G [REDACTED] me 8 Prill 2008 K [REDACTED] P [REDACTED] ka nxjerr një ujdi gjyqësore që thotë si në vijim:

I PADITURI OBLIGOHET që ti paguaj paditësit F [REDACTED] G [REDACTED] nga K [REDACTED] shumën prej 16.000€ në ujdi të të gjitha formave të dëmtimit, lidhur me rastin e pa siguruar (siç) rastin e datës 13 shtator 2006. I PADITURI OBLIGOHET që ti paguaj paditësit shumën prej 800€ në baze të ujdise mbi shpenzimet e procedurës.

Këto shuma duhet të paguhet në llogarinë bankare të L [REDACTED] P [REDACTED] në bankën P [REDACTED] brenda 15 ditëve nga dita e nënshkrimit të ujdise. Pas transferimit të fondeve në llogari të të pandehurit L [REDACTED] P [REDACTED], ai i ka dhënë të hollat K [REDACTED] P [REDACTED] i cili me pas i ka ndare në mes tyre sipas marrëveshjes.

Me anë të secilës ka kryer veprën penale të:

Shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit në kundërshtim me nenin 422 (1) të KPRK-se, dhe duke i ndihmuar ish gjyqtarit K [REDACTED] P [REDACTED], i lidhur me veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshëm të vendimeve të gjykatës në kundërshtim me nenin 432 i lidhur me nenin 33 dhe nenin 3 (2) të KPRK-se

Nga kjo gjykata shqipton dënimin vijues:

I pandehuri I [REDACTED] S [REDACTED],

- Në baze të nenit 422 (1) të KPRK-se për veprën penale të lartcekura dënohet me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjet e gjashtë (6) muaj.
- Kundër të pandehurit I [REDACTED] S [REDACTED], në mbështetje të nenit 65 (1) të KPRK-se, dënimi shtesë të ndalimit të ushtrimit të administrimit publik apo funksionet të shërbimeve publike shqiptohet për periudhën kohore prej dy (2) viteve pas shërbimit të dënimit me burgim.
- Në mbështetje të nenit 102 (1) të KPRK-se i pandehuri I [REDACTED] S [REDACTED] duhet të paguaj shpenzimet e procedurës të vlerësuar sipas gjykatës në shumën prej 250€.

Palët e dënuara mund të ushtrojnë padi për kompensim përmes gjykatës civile.

GJYKATA THEMELORE E PEJES

P.nr.386/13

Data: 8 Prill 2013

Procesmbajtësja

Kryetarja e trupit gjykues


Jacqueline Ryan

Mariola Pasnik

Anëtar të trupit gjykues

Anëtar të trupit gjykues

Manuel Soares



Lunturiqe Muhaxherri

MJETI LIGJOR:

Në mbështetje të nenit 400 (1) të KPPK-se medoemos duhet të shpallet ankesa brenda tete (8) ditëve nga dita e shpalljes së këtij aktgjykimi dhe duhet të ushtrohet në gjykatën e instancës së parë.

Personat të autorizuar mund të ushtrojnë ankesën në forme të shkruar kundër këtij aktgjykimi përmes gjykatës themelore të Pejës në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda 15 ditëve nga dita kur kopja e aktgjykimit është dorëzuar, në mbështetje të nenit 398 (1) të KPPK-së.